



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

**TITULLI I RASTIT:**

# DONACION I NJËJTË MASA TË NDRYSHME

**Interesi publik:** Avancim i mjedisit jetësor

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Dhurues
Shoqata e qytetarëve B me qëllim kryesor avancimin e ambientit jetësor	Mjete financiare në vlerë prej 600.000 denarëve për furnizime të fidaneve për pyllëzim, me qëllim të avancimit të mjedisit jetësor në Komunën Qendër	Shoqata tregtare A

## ÇKA KA NDODHUR?

Shoqata tregtare A ka lidhur marrëveshje për donacion me shoqatën e qytetarëve B. Lënda e donacionit janë mjete financiare në vlerë prej 600.000 denarëve, me qëllim të realizimit të interesit publik në fushën e avancimit të mjedisit jetësor në Komunën Qendër. Në kontratën për donacion është theksuar se shoqata ka detyrim që me mjetet financiare nga donacioni të kryejë furnizim të fidaneve për pyllëzim të rajonit në Komunën Qendër.



Shoqata e qytetarëve pas kërkesës së parashtruar, ka marrë vendim pozitiv nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, me të cilën vërtetohet interesi publik, ndërsa pas mendimit të marrë paraprakisht nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Shoqata e qytetarëve pjesën më të madhe të mjeteve i ka shfrytëzuar për furnizim të fidaneve nga kompania V në vlerë prej 400.000 denarëve. Një pjesë tjetër e mjeteve financiare të dhuruara, gjegjësisht 130.000 denarë nga ana e qytetarëve B janë shfrytëzuar për mbulim të shpenzimeve për transport të personave të angazhuar për pyllëzimin, që është kryer nga ana e kompanisë transportuese G. Pjesa tjetër e mjeteve financiare janë paguar për mbulim të shpenzimeve në vlerë prej 70.000 denarëve për shërbim të kryer nga kompania D, e cila ka qenë e ngarkuar që ta organizojë dhe përcjellë realizimin e pyllëzimit.



Për aktivitetet e theksuara, nga ana e kompanive të përmendura janë porositur faktura në të cilat janë theksuar të mirat materiale dhe shërbimet që janë porositur, e në të cilat në mënyrë përkatëse është llogaritur tatimi i vlerës së shtuar.

Fakturat e ndryshuara së bashku me dëshmitë për pagesë të tatimit të vlerës së shtuar në llogarinë e veçantë të Buxhetit të RM-së nga ana e kompanive të lartpërmendura si dhe kërkesa e formularit të caktuar dhe kopja nga vendimi i Ministrisë së Drejtësisë, nga ana e Shoqatës së qytetarëve B janë dorëzuar në Ministrinë e Financave, me qëllim që kompanive t'u kthehet tatimi pagesori vlerës së shtuar.

## SI ËSHTË VEPRUAR

Nga a e Ministrisë së Financave është kryer kthimi i tatimit pagesor të vlerës së shtuar të kompanisë V, e cila në fakturën e saj ka theksuar se janë porositur fidane. Në pjesën që i përket kompanive G dhe D, ku në mënyrë përkatëse është shprehur dërgesa e shërbimit transportues, gjegjësisht organizimi dhe përcjellja e realizimit të pyllëzimit kërkesa është refuzuar nga shkaqe që në kontratën për donacion është theksuar se mjetet e dhuruara mund të përdoren për furnizim të fidaneve, që nënkupton se mjetet tjera të dhuruara nuk janë shfrytëzuar konform qëllimit të vërtetuar në kontratën për donacion.

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Duke pasur parasysh se interesi publik është avancim i mjedisit jetësor, e cila do të realizohet me pyllëzim të fidaneve, organi është dashur ta përcjellë interesin publik, gjegjësisht realizimin e qëllimit, e jo mjetet që janë përdorur gjegjësisht furnizuar për realizimin e qëllimit, sipas së cilës edhe tatimi i paguar i vlerës së shtuar duhet t'i kthehet tre kompanive (kompanisë V, G dhe D). Detyrimi i mbetet pranuesit të donacionit, në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë të dëshmojë se të mirat materiale dhe shërbimet e furnizuara janë për qëllime të realizimit të interesit publik në fushën për të cilën e njëjta është konfirmuar.

**SFIDË:** Përkufizimi për atë çka është interesi publik është lëndë e interpretimit të gjerë dhe nëpunës të ndryshëm përgjegjës mund të kenë interpretim të ndryshëm ndërsa rast të njëjtë.




## VENDIM

### ► ndryshim i përkufizimit për interes publik

Mënyra në të cilën shprehja interes publik është përkufizuar në ligjin aktual është konfuz, i paqartë dhe nuk është në pajtim me definimin e termit të njëjtë në ligje tjera nacionale. Për këtë propozojmë ndryshim të definicionit të përfshirë me nenin 3 me ç'rast i njëjti do të qëndronte:

**Interes publik** është mbështetje apo

promovim i veprimtarive në fushën e zhvillimit të demokracisë, shoqërisë civile dhe promovit dhe mbrojtje e të drejtave dhe lirive të njeriut, mbrojtje e fëmijëve dhe të rinjve personave të marginalizuar dhe kyçja e tyre sociale në promovimin e kultures, etikës, arsimit shkencës, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, zhvillimit të shoqërisë informatike dhe bartjes së të dhënave elektronike, sportit, mbrojtje e mjedisit jetësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit lokal dhe infrastrukturor, ndihmës humanitare dhe sociale, mbrojtje dhe kujdes për kafshët, avancim i filantropisë dhe vullnetarizimit, mbrojtje e konsumatorëve, veprimtarive socio-humanitare ndihmë dhe mbrojtje e personave me handicap fizik apo mendor, personave me pengesa në zhvillim dhe personave me nevoja të veçanta, promovim i dhurimit të gjakut, promovim i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe veprimtarive tjera të vërtetuara me ligj;



**KYÇU!**  
**PLANIFIKO!**  
**DHURO!**

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbajtjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

**TITULLI I RASTIT:**


# MË SHUMË DONATORË VENDAS DHE TË HUAJ, MË MIRË PËR TË GJITHË

**Interesi publik:** Mbështetje e zhvillimit lokal dhe infrastrukturor

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Dhurues
Komuna A	Mjete financiare për realizimin e projektit për rikonstruksion të shkollës fillore	Personi juridik B dhe personi i huaj fizik V

## ÇKA KA NDODHUR?

Komuna A, për realizimin e projektit për rikonstruksion të një shkolle fillore në territorin e saj në vitin 2015 ka marrë si donacion një sasi të caktuar të mjeteve financiare nga personi juridik B nga komuna e njëjtë, si dhe nga personi i huaj fizik V.



## SI ËSHTË VEPRUAR

Personi juridik B për vlerën e mjeteve të dhura e ka shfrytëzuar lehtësimin tatimor nga tatimi i furnizimit, duke pasur parasysh atë se vlera e mjeteve të dhuruara nuk ka qenë më e lartë se 5% nga të ardhurat e tij. I njëjti i ka shfrytëzuar edhe dispozitat e nenit 19 nga Ligji për donacione dhe sponsorizime, kështu që në afat prej 30 ditëve nga dita e e plotësimit të Marrëveshjes, ka dorëzuar deri te Drejtoria për të ardhura publike, Raport për donacionin e dhënë të formularit "UJP-IDS/DV" në kuadër të së cilës ka dorëzuar edhe kopje nga Kontrata për donacion, kopje nga Vendimi për vërtetimin e interesit publik të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë dhe konfirmim për donacionin e pranuar.

Gjithashtu, në fund të shkurtit të vitit 2016, për qëllimet e realizimit të nxitjes tatimore, drejt Bilancit tatimor për vërtetimin e tatimit të fitimit për vitin 2015, ka dorëzuar kopje nga kontrata e donacionit, kopje nga vendimi i marrë nga Ministria e Drejtësisë, me të cilën vërtetohet se interes publik i donacionit, vërtetimi me shkrim për donacionin e pranuar si dhe dëshmi për pagesën e mjeteve.

Për dallim nga ai, personi i huaj fizik V, i cili me donacionin e dhënë ka dashur vetëm të ndihmojë në krijimin e kushteve më të mira për mësim të nxënësve nga shkolla në të cilën para shumë viteve prindërit e tij e kanë kryer arsimin, ka konsideruar se me marrëveshjen e lidhur për donacion dhe pagesë të mjeteve të paguara financiare, procedurat e tij administrative kanë përfunduar dhe për këto shkaqe nuk ka dorëzuar Raport për donacionin e dhënë.

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Detyrimi për dorëzimin e Raportit për donacionin e dhënë i parashikuar me paragrafin 1 nga neni 19 i Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike i përfshin edhe personat e huaj fizikë si dhurues të donacionit, por duke pasur parasysh atë që raporti për raportin e pranuar (formularin "UJP-IDS/PR") ka për detyrë ta plotësojë dhe dorëzojë pranuesi i donacionit, i përmban të dhënat e njëjta gjegjësisht të dhënat për dhuesin e donacionit; të dhënat për pranuesin e donacionit dhe përshkrimin e donacionit, si dhe dhe dokumentat e njëjta që dorëzohen, shtrohet pyetja nëse është e domosdoshme të ekzistojë detyrim ligjor dhe dhuruesi i donacionit, sidomos një person i huaj fizik apo juridik të dorëzojë raport për donacionin e dhënë.

**SFIDË:** Ngarkesë administrative i personave të huaj dhe vendor – dhurues të donacionit

## VENDIM

### ► **Pezullim i detyrimit për dorëzim të Raportit për donacionin e dhënë nga ana e personave të huaj fizikë**

Në drejtim të uljes së ngarkesës administrative të personave të huaj – dhurues të donacionit, i cili mund të paraqesë pengesë që personat e huaj të donojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nevojitet që të njëjtat të përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në nenin 19 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, gjegjësisht nga detyrimi në afat prej 30 ditëve nga dita e plotësimit të Kontratës të dorëzojnë në Drejtorinë për të ardhura publike Raport për donacionin e dhënë.

Ligji për donacione dhe sponsorizime duhet të ndryshohet që ta bëjë donacionin më të thjeshtë.

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbatjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjesisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

**TITULLI I RASTIT:**

# QYTETARËT DO TË DHUROJNË MË TEPËR NËSE MUNDEN LEHTË TA LIROJNË TATIMIN

**Interesi publik:** Shkupi më i pastër

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit / sponsorizim	Dhurues
Shoqata e qytetarëve A	Mjete financiare në vlerë prej 5.000 denarëve	Një qytetari Shkupit

## ÇKA KA NDODHUR?

Një qytetar i Shkupit në shkurt të vitit 2016 i ka dhuruar 5.000 denarë shoqatës ekologjike A që ndërmerr dhe përfaqëson për masa për një Shkup më të pastër. Donacionin qytetari me dëshirë të tij e ka paguar në ditën e lidhjes së Marrëveshjes për donacion me Shoqatën A, ndërsa pas një periudhe të shkurtër ka marrë edhe Vendim nga Ministria e Drejtësisë pas kërkesës së parashtruar për vërtetimin e interesit publik, si dhe vërtetim për donacion të pranuar nga ana e Shoqatës A.



## SI ËSHTË VEPRUAR

Qytetari gjatë vitit 2016 nuk ka realizuar lloje tjera të të ardhurave përveç rrogës. Për këto shkaqe deri në mars të vitit 2017 nuk e ka dorëzuar në Drejtorinë për të ardhura publike formularin "PDD-GDP" – paraqitjen vjetore tatimore për vërtetimin e tatimit personal të të ardhurave

Me atë që nuk ka deponuar paraqitje vjetore tatimore ai nuk ka pasur mundësi ta shfaq vlerën e donacionit të dhuruar dhe me këtë e ka humbur mundësinë ta shfrytëzojë të drejtën e nxitjes tatimore nga tatimi personal i të ardhurave që ia jep Ligji.

Njëherit, sipas nenit 13 nga Ligji i donacioneve dhe sponsorizimeve në veprimtaritë publike, si dhe sipas nenit 87 nga Ligji për tatim personal të të ardhurave, dhuruesi i donacionit në bazë të kontratës për donacion, ka të drejtë në ulje të tatimit të të ardhurave të llogaritura dhe të papaguara personale apo kthim të tatimit të paguar personal të të ardhurave të vërtetuar në bazë të Paraqitjes së tij tatimore vjetore (formulari "PDD-GDP") në vlerë të donacionit, por jo më shumë se 20 % të vlerës së tatimit të tij vjetor personal të të ardhurave, ndërsa më së paku deri në 24.000 denarë.

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Duke pasurparasysh se në vitin 2016, qytetari ka realizuar të ardhura në bazë të vlerës së përgjithshme prej 480.000 denarëve, ndërsa nga ana e punëdhënësit i është llogaritur dhe paguar tatimi personal i të ardhurave në vlerë prej 26.212 denarë ai ka pasur të drejtë të kërkojë kthim të një pjese të tatimit të paguar personal të të ardhurave, gjegjësisht për gjithë vlerën e donacionit të dhënë prej 5.000 denarëve, sepse 20% e 26.212 është 5.242 denarë, ndërsa nuk është tejkaluar as pragu ligjor prej 24.000 denarëve.

Për ta realizuar të drejtën e kthimit të tatimit personal të të ardhurave për vlerën e donacionit të dhënë prej 5.000 denarëve, qytetari është dashur të parashtojë Paraqitje vjetore tatimore për të ardhurat publike së bashku me dokumentet vijuese:

- ▶ kopje nga kontrata për donacionin;
- ▶ kopje nga Vendimi për vërtetimin e interesit publik të miratuar nga Ministria e Drejtësisë;
- ▶ vërtetim me shkrim për donacionin e pranuar dhe
- ▶ dëshmi për pagesë të mjeteve.

### SFIDA:

- ▶ Procedurë e gjatë komplekse për lirim tatimor të qytetarëve
- ▶ Qytetarët nuk janë të motivuar ta shfrytëzojnë ligjin
- ▶ Pengesa shtesë për shfrytëzimin e lirimit tatimor

## VENDIM

Ndryshimet e Ligjit për donacione dhe sponsorizim në veprimtaritë publike duhet të sigurojnë rritje të shkallës së shfrytëzimit të nxitjes tatimore tek tatimi personal i të ardhurave/tatimi i të hyrave personale.

- ▶ **Rritje e vlerës së nxitjes tatimore**
- ▶ **Miratim i aktit nënligjor konform Ligjit të ri për tatimin e të ardhurave personale të ndërlidhur me shfrytëzimin e nxitjes tatimore**
- ▶ **Zbatim efikas i procedurës për realizimin e nxitjes tatimore tek tatimi personal/tatim i të ardhurave personale**

Me rritjen e vlerës ekzistuese të nxitjes tatimore prej 24.000 denarëve, të parashkuar në Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, Ligjin për tatimin personal të të ardhurave dhe në Ligjin për tatimin e të ardhurave personale (ky ligj ka filluar të zbatohet nga 1 janari i vitit 2018, me çka është ndërprerë zbatimi i Ligjit për tatimin personal të të ardhurave), drejtpërdrejtë do të nxiten qytetarët të dhurojnë më shumë mjete, ndërsa me këtë do të rritet edhe numri i donatorëve të donacioneve që do ta përdorin nxitjen tatimore.

Në Ligjin e ri për tatimin e të ardhurave personale, në nenin 75 është caktuar se për realizimin e nxitjes tatimore personi fizik-dhruues i donacionit, dorëzon raport deri te organi për të ardhura publike deri më 31 janar të vitit ardhshëm. Nga ky këndvështrim, nevojitet që të miratohet akti nënligjor, me të cilin do të rregullohet forma, përmbajtja dhe mënyra e dorëzimit dhe aprovimit të raportit. Ai duhet të jetë i thjeshtë dhe nuk duhet t'i dekurajojë qytetarët të donojnë. Gjithashtu në drejtim të rritjes së shkallës së shfrytëzimit të nxitjes tatimore sidomos është me rëndësi të sigurohet zbatim konsekuent i procedurës për realizimin e nxitjes tatimore në praktikë, gjegjësisht qytetarëve t'u mundësohet ulje e vlerës së taksës së vërtetuar të të hyrave personale.

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbatjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

## TITULLI I RASTIT:

# NXITJE TATIMORE PËR ÇDO MASË

**Interesi publik:** Avancimi i shëndetit

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Donator
Shoqata e qytetarëve B	Mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve për mjekim të fëmijëve që janë të sëmurë nga sëmundje të rralla	Shoqata tregtare A

### ÇKA KA NDODHUR?

Shoqata tregtare A duke u nisur nga aspekti humanitar si dhe nga angazhimi i tij që ta rrisë përgjegjësinë shoqërore, ka vendosur që të dhurojë mjete financiare, që do të shfrytëzoheshin për pagesën e shpenzimeve që shkaktohen në procesin e mjekimit të fëmijëve që janë të sëmurë nga sëmundje të rralla. Për këtë qëllim, shoqata tregtare A ka vendosur kontakt me shoqatën B për mbrojtjen e qytetarëve që janë të sëmurë nga sëmundje të rralla dhe kanë lidhur kontratë për donacion me të njëjtën.

Pasi që shoqata e qytetarëve B ka marrë vendim pozitiv nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, me të cilën është vërtetuar interesi publik, Shoqata tregtare A ka kryer pagesën të 350.000 denarëve në llogarinë e shoqatës B në emër të donacionit.



### SI ËSHTË VEPRUAR

Duke pasur parasysh se shoqata tregtare A bën pjesë në regjimin më të thjeshtë tatimor, i cili konform dispozitave të Ligjit për tatim të fitimit nënkupton se shoqata paguan tatim vjetor të të ardhurave të përgjithshme, në vlerë prej 1% nga sasia e të ardhurave të realizuara përmes të gjitha bazave në vitin afarist, e njëjta duke parasysh parasysh regullativën ekzistuese nuk ka pasur të drejtë në nxitjet tatimore për vlerën e dhuruar prej 350.000 denarëve shqatës B.

Njëherit, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike si dhe sipas nenit 9 të Ligjit për tatim të fitimit, obliguesit tatimor të tatimit të fitimit që i ka donuar mjete personit juridik, vlera e donacionit të dhënë në vitin vijuesi pranohet si shpenzim në vlerë deri në 5% nga të ardhurat e përgjithshme.

Ky lloj i nxitjes tatimore është relevant, respektivisht i zbatueshëm vetëm për kompanitë që bëjnë pjesë nën regjimin "regullator" të tatimit me taksën e fitimit që nënkupton tatim sipas shkallës prej 10% të fitimit të realizuar të rritur për vlerën e shpenzimeve të papranuara për qëllime tatimore.

Nëse shoqata tregtare A ka paguar tatim të fitimit, në vend të tatimit vjetor të të ardhurave të përgjithshme, e njëjta do të ketë mundësi ta shfrytëzojë nxitjen tatimore të parashikuar në nenin 14 nga Ligji për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, gjegjësisht të fitojë të drejtën që një pjesë apo gjith vlera e donacionit të ketë trajtim të shpenzimeve të pranuar në bilancin tatimor, e me këtë të paguajë edhe vlerë më të ulët të tatimit të fitimit.

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Rregullativa ligjore duhet të mundësojë nxitje tatimore edhe kompanive që tatimizohen në të ardhura të përgjithshme vjetore, me qëllim që të njëjtat të motivohen të donojnë mjete.

**SFIDË:** Nxitje tatimore për shoqatat tregtare që bëjnë pjesë nën regjim më të thjeshtë tatimor.

## VENDIM

- ▶ **Ndryshime të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike dhe Ligjit për tatimin e fitimit, në drejtim të caktimit të nxitjes tatimore për shoqatat tregtare që bëjnë pjesë nën regjim më të thjeshtë tatimor.**
- ▶ **Përshtatje e formularit "DB-VP" – Tatim vjetor i të ardhurave të përgjithshme**

Në drejtim të nxitjes së vëllimit të donacioneve nga ana e shoqatave tregtare që janë në kuadër të regjimit të thjeshtësuar tatimor në pajtim me Ligjin për tatimin e fitimit, nevojitet që të kryhen ndryshime dhe plotësime të dispozitave nga Ligji për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike dhe Ligjin për tatimin e fitimit, me të cilat do të caktohen nxitje tatimore edhe për këtë kategori të shoqatave.

Pas ndryshimeve të kryera të Ligjit për tatimin e fitimit, duhet të kryhet edhe përshtatje e formularit "DB=VP"- Tatim vjetor i të ardhurave të përgjithshme, për shkak të parashikimit të hapësirës në formularin përmes së cilës do të implementohet nxitimi i caktuar tatimor në ligj.

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbatjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financiare që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.





Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

## TITULLI I RASTIT:

# NDËRLIDHJE E PËRMBJATJES SË KONTRATËS PËR DONACION DHE SHFRYTËZIM I NXITJES TATIMORE TE TATIMI I FITIMIT

Interesi publik: Avancimi i sportit

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Dhurues
Klubi sportiv B	Pajisje sportive në vlerë prej 700.000 denarëve	Kompania A

### ÇKA KA NDODHUR?

Gjatë tetorit të vitit 2016 kompania A ka marrë vendim t'i dhurojë pajisje sportive një klubi të vogël B, me qëllim që anëtarëve të klubit B në mënyrë të papenguar dhe profesionale t'i kryejnë aktivitetet sportive.



Me klubin sportiv B është lidhur Kontratë për donacion në të cilin është rregulluar se kompania A do t'i dhurojë pajisje sportive në vlerë prej 700.000 denarëve. Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë kompanisë A i është lëshuar Vendim për vërtetimin e interesit publik të donacionit dhe nga fundi i nëntorit të vitit 2016 pajisja e dhuruar i është dorëzuar në dispozicion klubit sportiv B.

Duke pasur parasysh atë se pas përroitjes së llogarisë përfundimtare për vitin 2016, është vërtetuar se kompania A ka realizuar gjithsej të ardhura në vlerë prej 15.000.000 denarëve, e njëjta si obligues tatimor i tatimit të fitimit ka marrë të drejtën ta shfrytëzojë nxitjen tatimore të parashikuar në nenin 14 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike për gjithë shumën e donacionit të dhënë, respektivisht ka marrë të drejtën gjithë vlera e donacionit të dhënë të trajtohet si shpenzim i pranuar në bilancin tatimor.

- ▶ Të ardhura të përgjithshme 15.000.000 denarë
- ▶ Nxitje e lejuar maksimale tatimore 15.000.000 denarë x 5%=750.000 denarë
- ▶ Vlera e donacionit të dhënë 700.000 denarë (700.000< 750.000) .

Nga këtu kompania A gjatë përgatitjes së bilancit tatimor në fushën "Shpenzime për donacione të bëra në pajtim me Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, mbi 5% e të ardhurave të përgjithshme të realizuara në vit e ka regjistruar vlerën prej 700.000 denarëve.

### SI ËSHTË VEPRUAR

Për këto shkaqe, organi tatimor ka vlerësuar se kontrata e lëndës për donacion në të vërtetë do të duhet të paraqesë kontratë për sponsorizim, që nënkupton se kompania A është dashur të shfaq më pak vlera në emrin shpenzime të pranuar në bilancin tatimor. Kjo për shkak të faktit që në pajtim me nenin 14 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, si dhe sipas nenit 9 të Ligjit për tatimin e fitimit, obliguesit tatimor i tatimit të fitimit, i cili ka sponsorizuar mjete të personit juridik, vlera e sponsorizimit të dhënë në vitin vijues i pranohet si shpenzim në vlerë deri 3% nga të ardhurat e përgjithshme.

Në rastin konkret, nxitja tatimore tek tatimi i fitimit për kompaninë A është dashur të jetë 450.000 denarë në vend të 750.000 denarëve, pas çka nga ana e organit tatimor është vërtetuar vlerë shtesë e tatimit, të cilën kompania është dashur ta paguajë për shkak të vlerës më të lartë të shpenzimeve, ka vërtetuar bazë më të ulët tatimore, ndërsa mënyrë konsekuente në të ka paguar edhe vlerë më të vogël të fitimit.

- ▶ Të hyra të përgjithshme 15.000.000 denarë
- ▶ Nxitje e lejuar maksimale tatimore 15.000.000 denarë x 3%=450.000 denarë
- ▶ Vlera e sponsorizimit 700.000 denarë (700.000> 450.000)

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Në marrëveshjen për donacion dy palët kontraktuese (kompania A dhe klubi sportiv B) është dashur të kyçin dispozicion që parashikon se dhuruesi nuk ka dobi direkte nga donacioni i dhënë, as se pranuesi i donacionit ka ndonjë detyrim kundrejt donatorit. Palët kontraktuese kanë mundur t'i shfrytëzojnë përvojat e personave tjerë që kanë lidhur lloj të këtyllë të marrëveshjes ose ta shfrytëzojnë propozim-terkun e kontratës për donacion i kapshëm në sajtin [www.donirajpametno.mk](http://www.donirajpametno.mk).

**SFIDË:** Mospasja e mundësisë për rikualifikim të kontratës për donacion në kontratë për sponsorizim

## VENDIM

- ▶ Informim më i madh për përmbajtjen e domosdoshme të kontratës për donacion dhe qasje më e lehtë e propozim-terkut të dispozitave, të cilat duhet t'i përmbajë kontrata për donacion apo
- ▶ Edukim i elementeve kryesore dhe dispozita, të cilat duhet t'i përmbajë kontrata për donacion

Që të parandalohet mundësia në praktikë që organi tatimor ta rikualifikojë kontratën për donacion në kontratë për sponsorizim për shkak të mungesës së dispozitës përkatëse, e cila qartë tregon se bëhet fjalë për kontratë për donacion, e jo kontratë për sponsorizim, nevojitet të rritet shkalla e informimit të dhuruesve dhe pranuesve të donacioneve për përmbajtjen e kontratës për donacion, e cila është e domosdoshme që e njëjta të rikualifikohet si kontratë për donacion. Gjithashtu nevojitet të lehtësohet edhe qasja e shembujve-terqe të kontratave për donacion, të cilat mund t'i përdorin palët e kontraktuara gjatë përgatitjes së tekstit së kontratës. Do të mund të shqyrtohet edhe mundësia që elementet bazë dhe dispozitat bazë që duhet t'i përmbajë një kontratë për donacion ose ndonjë akt tjetërme shkrim (vërtetim) të caktohen në aktin nënligjor.

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbajtjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri" është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

**TITULLI I RASTIT:**

# PROCEDURË E GJATË DONATORË TË PASIGURT

**Interesi publik:** Mbështetje e arsimit

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit	Donator
Fondacioni B	Mjete financiare në vlerë prej 240.000 denarëve për financim të programit të fondacionit B për pagesë të bursave	Kompania A Kompania B(anuluar)

## ÇKA KA NDODHUR?

Me qëllim që t'u ndihmojë të rinjve dhe personave të talentuar, të cilët nuk kanë mjaftueshëm mjete financiare ta financojnë arsimimin e tyre, kompania A si kompani përgjegjëse shoqërore, gjatë vitit 2018 ka themeluar fondacionin B për mbështetje të arsimit të studentëve në shkencë teknike. Përmes fondacionit B, në disa vitet e ardhshme, kompania A ka ndarë bursa për dhjetë studentë. Me bursimin e studentëve, kompania A ka dashur të investojë edhe në ndërtimin e kuadrit të tij të ardhshëm, duke siguruar mundësi që studentët të punësohen në kompani pas përfundimit të arsimit.



Duke u nisur nga ky qëllim kryesor, në dhjetor të vitit 2014 kompania A ka lidhur kontratë për donacione me fondacionin B, në bazë të së cilës ajo është dashur t'i ndajë, gjegjësisht paguajë 240.000 denarë për financim të programit të fondacionit për pagesë të bursave dy studentëve të regjistruar në ndonjërin nga fakultetet teknike në vend.

Kompania A e ka dorëzuar kërkesën për vërtetimin e interesit publik të donacionit gjatë dhjetorit të vitit 2014 në arkivën e Ministrisë së Drejtësisë së bashku me kontratën e lidhur dhe e ka paguar vlerën prej 240.000 denarëve të fondacionit B.

Ministria e Drejtësisë e jep vendimin për nëse donacioni është me interes publik pasi që do të marrë mendim nga institucioni dikasterial. Për mendimin është pritur më shumë se që është parashikuar. Në mënyrë shtesë, pas mendimit të marrë të vonuar për shkak të ngarkesës administrative dhe ndërrimit të Ministrisë së Drejtësisë deri në fund të vitit 2014 nuk ka arritur të marrë vendim pas kërkesës së parashtruar të kompanisë A-dhuruar të donacionit.

Për shkak të së cilës deri në skadim të vitit afarist 2014, kompania A nuk ka disponuar me Vendimin e përmendur si dokument i domosdoshëm për shfrytëzimin e nxitjes tatimore tek tatimi i fitimit, ajo do të ketë mundësi që donacionin e dhënë në vlerë prej 240.000 denarëve ta shfaqë në bilacin tatimor, si vendikt i pranuar për qëllimet e vërtetimit të tatimit të fitimit.

Lidhur me të ardhurat e përgjithshme të realizuara të kompanisë A, vlera e dhuruar (240.000 denarë) nuk ka tejkaluar 5%, por për shkak se kompania nuk disponon me vendimin për vërtetimin e interesit publik i është shkurtuar e drejta e e vlerës së donacionit të dhënë të ketë trajtim të shpenzimeve të pranuar dhe të paraqet shkallë refuzuese gjatë vërtetimit të tatimit të fitimit për vitin afarist 2014.

Në mënyrë shtesë dispozitat e nenit 21 të Ligjit të donacioneve dhe sponsorizimeve në veprimtaritë publike e përshkruajnë procedurën dhe hapat që ndërmerren në rast që të merret Vendim për vërtetimin e interesit publik, janë në pajtueshmëri me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë") nr. 38/05, 110/08 dhe 51/11), por ky ligj nuk zbatohet më me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15). Dispozitat e ligjit 21 nga Ligji nuk janë harmonizuar me dispozitat e reja të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Për shkak të këtij rasti kompania B e cila është e interesuar të dhurojë për qëllimin e njëjtë ka hequr dorë ta bëjë këtë sepse ka dëgjuar për procedurën e komplikuar administrative dhe se nuk është pararakshë e qartë nëse mund ta shfrytëzojë të drejtën e lirimit tatimor.



## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Në pajtim me ligjin aktual ekziston afat prej 15 ditëve pas marrjes së mendimit nga organet kompetente (neni 21 nga Ligji për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike) Ministria e Drejtësisë është dashur kompanisë A – donator t'i lëshojë vendim për vërtetimin e interesit publik. Procedura përfshin edhe institucion shtesë/organ në të cilin duhet të japë mendim. Kjo bëhet për çdo donacion dhe sponsorizim për të cilat dhuruesit dhe pranuesit duan të shfrytëzojnë lehtësime tatimore.

Në rast që procedura është më e thjeshtë, kompania A do të ketë mundësi të shfrytëzojë nxitje tatimore tek tatimi i fitimit. Njëherit kompania do të ketë mundësi gjithë vlerën e donacionit të dhënë prej 240.000 denarëve ta shfaq në bilancin tatimor si shpenzim të pranuar për qëllimet e vërtetimit të tatimit të fitimit dhe me këtë të paguajë sasi më të vogël të tatimit të fitimit. Në mënyrë plotësuese, procedura ka dekurajuar edhe një donator potencial (kompania B).

### SFIDA:

- ▶ Procedurë e gjatë administrative
- ▶ Sjellje jo me kohë e vendimit për vërtetimin e interesit publik.
- ▶ Ngarkesë administrative për institucionet
- ▶ Pasiguri juridike se donacioni do të gëzojë lehtësim tatimor
- ▶ Shfrytëzues të dekurajuar të ligjit = më pak donacione

### VENDIM

**Ndryshim i Ligjit donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike**

- ▶ Procedurë e thjeshtë administrative, ngarkesë e ulur për institucionet
- ▶ Mundësi që donatorët pararakisht të dinë nëse donacioni do të gëzojë lehtësime tatimore

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbatjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



### PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

**TITULLI I RASTIT:**

# PENGESË E PAPENGUAR E HYRJES NË VEND

**Interesi publik:** Promovim i sportit

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Dhurues
Shoqatë e qytetarëve nga fusha e sportit B me seli tek ne	Pajisje specifike sportive ër avancimin e sportit	Shoqata e qytetarëve nga fusha e sportit A me seli jashtë vendit

## ÇKA KA NDODHUR?

Shoqata e qytetarëve nga fusha e sportit A ne seli jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje për donacion me shoqatën e qytetarëve B me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila gjithashtu është nga fusha e sportit.

Lëndë e donacionit është pajisja specifike sportive, me qëllim të realizimit të interesit publik nga fusha e sportit në vlerë prej 100.000 denarëve.


Pajisja meqë dhurohet nga ana e një subjekti që është me seli jashtë vendit, është lëndë e importit në të cilën llogariten të dhëna importuese duke përfshirë edhe tatimin e vlerës së shtuar.

Sipas dispozitave ekzistuese të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, me të cilat rregullohen nxitjet tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar, nuk është parashikuar kthim i tatimit të vlerës së shtuar, kur i njëjti është paguar gjatë importit të të mirave materiale që janë lëndë e donacionit, ndërsa për të cilin është vërtetuar interes publik, edhe pse sipas ligjit është parashikuar se donatorë është një person i huaj.



## SI ËSHTË VEPRUAR

Personi që e importon pajisjen, për çka konform marrëveshjes paraqitet si pranues i donacionit, do t'i paguajë të gjitha të dhënat importuese që do të jenë në ngarkesë të tij, gjegjësisht këto mjete të paguara nuk do t'i kthehen ose nuk disponon me mjete personale, me të cilat do ta mbulonin këtë shpenzim, të njëjtat do të heqin dorë nga pranimi i donacionit.



## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Në rast kur në ligjin e lëndës është parashikur se personi i huaj mund të jetë donator, ndërsa personi vendas pranues i donacionit, ndërsa ku janë plotësuar kushtet sipas të cilave vërtetohet se donacioni i lëndës është me interes publik, pranuesi i donacionit nuk duhet të ngarkohet me sigurimin e mjeteve për të dhëna importuese.

**SFIDË:** Ngarkesa tatimore nuk guxon të jetë pengesë për realizimin e donacioneve, gjegjësisht nevojitet që të sigurohen nxitje tatimore për donacionet me interes publik, pavarësisht nëse dhuruesi i donacionit është e person i huaj apo vendor, respektivisht nëse kryhet import apo furnizim në vend.

## VENDIM

- ▶ **Lirim nga tatimi i vlerës së shtuar gjatë importit të mjeteve të dhuruara**

Në Ligj qëndron qartë dhe në mënyrë të padyshimtë se donatorë mund të jenë edhe persona të huaj dhe vendorë. Sipas kësaj nevojitet që të parashikohet edhe nxitja tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar ndërsa gjithashtu edhe për shpenzimet tjera importuese dhe të caktohet procedura për lirim kur të miat materiale importohen, të cilat shërbejnë për realizimin e interesit të caktuar publik.

- ▶ **Lirim nga tatimi i vlerës së shtuar edhe për qarkullimin e brendshëm, me zbatim të vendimit softuerik**

Gjithashtu duhet të mendohet në drejtim të krijimit të softuerit të veçantë në DAP sipas shembullit të donacioneve të huaja, me qëllim të lirimit direkt dhe për të mirat materiale dhe shërbimet të furnizuara nga vendi, nga shkaqe që kompani të caktuara, të cilat vetë prodhojnë të mira materiale dhe të njëjtat i dhurojnë nuk kanë interes ta paguajnë tatimin e vlerës së shtuar, i cili gjithashtu më vonë u kthehet. Me këtë do të shkurtohej edhe edhe njëra procedurë e ajo është procedura te Ministria e Financave që do të ndikojë pozitivisht edhe nga aspekti i likuiditetit tek dhuruesit dhe pranuesit të donacioneve. Ministria e Financave nuk do të shpenzojë resurse për këtë qëllim, ndërsa Drejtoria për të ardhura publike do të ketë bazë më adekuate për kontroll të donacioneve.

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbajtjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

## TITULLI I RASTIT:

# INTERESI PUBLIK ËSHTË MË I RËNDËSISHËM SE FORMA E DONACIONIT

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Donator
Institucioni arsimor (shkollë)	Mjete financiare në vlerë prej 1.500.000 denarëve për rikonstrukcion dhe adaptim të hapësirave shkollore, me qëllim të avancimit të sistemit arsimor	Shoqata e qytetarëve A

### ÇKA KA NDODHUR?

Shoqata e qytetarëve A lidh kontratë për donacion me institucionin arsimor (shkollë). Lëndë e donacionit janë mjete në para në vlerë prej 1.500.000 denarëve, me ç'rast është theksuar se qëllimi i mjeteve të donacionit është që të kryhet rikonstruksion dhe adaptim i hapësirave shkollore. Shoqata e qytetarëve këto mjete i ka mbledhur nga më shumë donatorë dhe nuk disponon me mjete financiare shtesë



Shoqata e qytetarëve A ka parashtruar kërkesë për vërtetimin e interesit publik dhe ka marrë vendim pozitiv nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me të cilën vërtetohet interesi publik, ndërsa pas mendimit pozitiv të marrë paraprakisht nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Pasi që është kryer kjo procedurë nga ana e institucionit arsimor është kërkuar në vend të mjeteve financiare lëndë e donacionit të jenë gjërat ndërtimore dhe zeytare me qëllim të rikonstruksionit dhe adaptimit të hapësirave shkollore në çka duke e pasur parasysh gjendjen e përgjithshme shoqata e qytetarëve A është dashur të pajtohet. Duke e pasur parasysh ndyshimin e lëndës së donacionit, shoqata e qytetarëve është dashur të parashtronte kontratë të re apo aneks të kontratës në Ministrinë e Drejtësisë dhe kërkesë për ndryshim të lëndës së donacionit në vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, e cila në bazë të dokumentacionit të parashtruar ka lëshuar vendim pozitiv, me të cilën vërtetohet interesi publik, ndërsa kuptohet me mendimit pozitiv të marrë paraprakisht nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Duke e pasur parasysh se shoqata e qytetarëve A nuk ka mundur në mënyrë të pavarur t'i kryejë punët ndërtimore dhe zeytare ka zbatuar furnizim publik dhe pas detyrimeve të realizuara nga ana e kompanisë së zgjedhur ndërtimore është dashur të paguajë me këto mjete të mbledhura financiare. Shoqata e qytetarëve me këto mjete e ka paguar edhe taksën e vlerës së shtuar me faturat e lëshuara nga kompania ndërtimore.

### SI ËSHTË VEPRUAR

Shoqata e qytetarëve A duke pasur parasysh se nuk është detyruar për qëllime të tatimit të vlerës së shtuar nuk ka pasur të drejtë të kërkojë kthim të tatimit të vlerës së shtuar në procedurë të rregullt të caktuar në Ligjin për tatim të vlerës së shtuar, ndërsa nga ana tjetër nuk ka mundësi as ti shfrytëzojë nxitjet tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar të caktuara në Ligjin e donacioneve dhe sponsorizimeve në veprimtaritë publike për dy shkaqe.

- ▶ Në kuadër të qarkullimit nga kompania e ndërtimit ndaj shoqatës së qytetarëve A, shoqata e qytetarëve nuk është pranues i donacionit dhe tatimi i vlerës së shtuar i shprehur nga ana e kompanisë ndërtimore nuk ka bazë ligjore t'i kthehet nga e Ministrisë së Financave që nënkupton se shoqata e qytetarëve do të duhet ta paguajë gjithë vlerën të theksuar në fakturën duke përfshirë edhe vlerën e tatimit të vlerës së shtuar.
- ▶ Në kuadër të qarkullimit nga shoqata e qytetarëve A dhe institucioni arsimor, shoqata e qytetarëve nuk është obligues tatimor që është regjistruar për qëllime të tatimit të vlerës së shtuar dhe nuk ka detyrim të shprehë tatim të vlerës së shtuar në fakturën kundrejt institucionit arsimor, ndërsa megjithatë duke pasur parasysh shpenzimin për rikonstrukcion dhe adaptim të hapësirave shkollore do ta theksojë vlerën e përgjithshme në sa edhe është shprehur në fakturën që e ka pranuar nga ana e kompanisë ndërtimore.

**Vërejtje:** Ajo që është shumë me rëndësi të potencohet në këtë rast është se nëse institucioni arsimor e ka pranuar donacionin në mjete financiare dhe ka kryer në mënyrë të pavarur furnizim nga kompania ndërtimore për rikonstrukcion dhe adaptim të hapësirave shkollore, shpenzimi për këto aktivitete do të ishte më i ulët për vlerën e tatimit të vlerës së shtuar nga shkak që do të ekzistonte bazë ligjore për kthimin e tatimit të vlerës së shtuar konform Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike duke pasur parasysh faktin se institucioni arsimor është pranues i donacionit. Kjo gjithashtu nënkupton se me mjete të pranuar financiare do të mund të furnizohen disa gjëra sesa kur këto furnizime kryhen siç është rasti nga ana e shoqatës së qytetarëve A, që nënkupton edhe interes më të madh publik.

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET NË PAJTIM ME PRAKTIKËN E MIRË

Shoqata e qytetarëve A, edhe pse nuk është pranuese e donacionit, megjithatë është implementues në realizimin e projektit edhe atë për shkak se e njëjta angazhohet në grumbullimin e mjeteve financiare dhe është drejtpërdrejtë e lidhur në realizimin e aktivitetit për rikonstruksion dhe adaptim të hapësirave shkollore, para se e njëjta t'i dorëzohet në mënyrë funksionale institucionit arsimor (shkollës) si sfrytëzues i fundit. Për këtë arsye edhe gjatë punës së mjeteve për realizimin e donacionit me interes publik duhet të përdoren nxitjet tatimore, gjegjësisht kompanive që do të kryejnë furnizime t'u kthehet tatimi i paguar i vlerës së shtuar, në vend që të pritet pagesë e tatimit të llogaritur në fakturën e porositur kundrejt shoqatës së qytetarëve A nga e të njëjtës.

**SFIDË:** Gjatë realizimit të këtij projekti duhet të shihet si donacioni i vetëm që fillon me dhurim të mjeteve financiare ndërsa përfundon me realizimin e aktivitetit-rikonstruksion dhe adaptim të hapësirave shkollore, në të cilin është i përfshirë edhe zbatuesi i projektit me ç'rast do të vlejnjë nxitjet tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar.

## VENDIM

- ▶ **parashikim i nxitjes tek tatimi i vlerës së shtuar për realizimin e projektit ku do të vendosen edhe implementuesi i projektit edhe shfrytëzuesi i fundit projektit**

Në ligj të parashikohet mundësia për nxitje tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar për realizimin e projekteve sipas shembullit të donacioneve të huaja, sipas të cilave në këtë rast shoqata e qytetarëve A do të ishte implementues i projektit, ndërsa institucioni arsimor në rastin konkret do të ishte shfrytëzuesi i fundit.

Në këtë mënyrë në rtin konkret do të përfshihej edhe qarkullimi nga kompanisë ndërtimore drejt shoqatës së qytetarëve A gjegjësisht tatimi i shprehur i vlerës së shtuar në fakturën e lëshuar nga kompania ndërtimore drejt shoqatës së tetarëve A do të kthehej nga ana e Ministrisë së Financave. Me këtë nxitje tatimore mund të kryhen numër më i madh i furnizimeve në krahasim me rastin e theksuar më lart konform vendimeve ekzistuese ligjore.

Gjithashtu duhet të merret parasysh se furnizimet mund të kryhet nga më shumë se një kompani, gjegjësisht se nuk bëhet fjalë për dhënie të thjeshtë të donacionit në të mira materiale dhe shërbime por se bëhet fjalë për realizim të projektit me vëllim më të madh dhe duhet të mendohet në mënyrë të përgjithshme të zbatohet sistemi i caktuar si tek donacionet e huaja me zbatim të lirimit të drejtpërdrejtë.

Gjithashtu vendimet e personave të caktuar për formën e donacionit nuk do të kishin sikur në këtë rast ndikim negativ në lidhje me interesin më të gjerë publik, e ajo është interesi i bashkësisë që është shfrytëzuesi i vërtetë i donacionit të dhënë (nxënësit në institucionin publik).

## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbatjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.





Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

TITULLI I RASTIT:

## JUSTIFIKIM I DONACIONIT

**Interesi publik:** Promovim i sportit

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Donator
Shoqata e qytetarëve me qëllim të avancimit të sportit	Pajisje fitnesi për avancimin e sportit	Shoqata tregtare A

### ÇKA KA NDODHUR?

Shoqata tregtare Aka lidhur kontratë për donacion me shoqatën e qytetarëve në fushën e sportit. Lënda e donacionit janë pajisjet për fitnes në vlerë prej 300.000 denarëve, me qëllim të relizimit të interesit publik nga fusha e promovimit të sportit.



Shoqata e qytetarëve pas kërkesës së parashtruar për vërtetim të interesit publik ka marrë vendim pozitiv nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me të cilën konfirmohet interesi publik, pas mendimit pozitiv të marrë paraprakisht nga ana e Agjencisë për të rinj dhe sport.

Pasi që kompania A e ka marrë vendimin, e ka kryer donacionin gjegjësisht pajisjet për fitnes i janë dorëzuar shoqatës së qytetarëve B.

Shoqata e qytetarëve B, fakturën e lëndës për pajisje të fitnesit, së bashku me dëshminë në pagesë të taksës së vlerës së shtuar të kryer nga shoqata tregtare A, si dhe vendimi pozitiv nga Ministria e Drejtësisë me kërkesë të formularit të caktuar i ka dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Konform Ligjit për donacione dhe sponsorizim në veprimtaritë publike, me të cilat është parashikuar kthimi i tatimit të paguar të vlerës së shtuar, i cili është i paguar për qarkullim të të mirave në rast të donacionit, nga ana e institucionit publik – Ministria e Financave nuk ka vepruar dhe është kthyer tatimi i vlerës së shtuar kryerësit të qarkullimit, gjegjësisht shoqatës tregtare A.

Më vonë organi hetues në procedurë të kontrollit vërteton se personi që është pranues i donacionit, ndërsa i cili siç është theksuar më lart është regjistruar si shoqatë e qytetarëve furnizon gjëra që janë në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe me këtë rast paguan shërbim për shfrytëzim të pajisjeve për fitnes në formë anëtarësie. Është shkaktuar konfuzion.

### SI ËSHTË VEPRUAR



Organi hetues tatimor ka vlerësuar se pavarësisht formës së regjistrimit se pranuesi i donacionit nuk kryen veprimtari publike, por veprimtari ekonomike pas së cilës ka vërtetuar se është vepruar në kundërshtim me Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike nga ana e dhuruesit dhe pranuesit të donacionit.



## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Shoqatat e qytetarëve mund të kryejnë veprimtari ekonomike. Të ardhurat nga veprimtaria ata nuk mund t'i ndajnë, por i shfrytëzojnë për qëllime për të cilat shoqata është formuar. Verifikimi duhet të kryhet si pasojë e këtyre karakteristikave dhe qëllimit të donacionit.

**SFIDË:** Nevojitet definim preciz i interesit publik në Ligjin për donacione dhe sponsorizime ose ndërlidhjes të saj me personin juridik pranues të donacionit. Institucioneve u nevjiten kritere të qarta përmes të cilave mund të udhëhiqen pa patur nevojë për interpretim.



## VENDIM

- ▶ **Interes publik të vlerësuar sipas pranuesit**

Për dhuruesin e donacionit, por edhe për institucionet në këtë rast do të jetë shumë më lehtë nëse paraprakisht është e qartë se donacionet e dhëna/sponsorizimet ndaj shoqatave të qytetarëve (ose një pjesë e tyre) janë të liruar nga tatimi. Ndërlidhja e interesit publik me personin juridik në vend me çdo donacion individual do ta rrisë shfrytëzimin e ligjit dhe donacionin në vendin tonë.



## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbajtjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjesisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- ▶ bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financuara që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- ▶ një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- ▶ 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



KONEKT



Projekti: Ndryshime për qëndrueshmëri

**TITULLI I RASTIT:**

## PROJEKTE, JO SUBJEKTE

**INTERESI PUBLIK:** Avancim i shëndetit të njerëzve

Pranues	Lënda dhe qëllimi i donacionit/sponsorizim	Donator
Institucion publik shëndetësor	Mjetet financiare në vlerë prej 1.000 000 000 denarëve, me qëllim të realizimit të interesit publik në fushën e shëndetësisë me qëllim për furnizim të pajisjes për tomografi kompjuterike.	Kompania A

### ÇKA KA NDODHUR?

Kompania A ka lidhur kontratë për donacion me institucionin publik shëndetësor. Lëndë e donacionit janë mjetet financiare në vlerë prej 1.000.000.000 denarëve, me qëllim të realizimit të interesit publik në fushën e shëndetësisë. Në kontratën për donacion është theksuar qartë se qëllimi i mjeteve financiare nga donacioni është që të kryhet furnizim i pajisjes për tomografi kompjuterike.



Institucioni publik shëndetësor pas kërkesës së parashtruar për vërtetim të nteretit publik ka marrë vendim pozitiv nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilën vërtetohet interesi publik, ndërsa pas mendimit pozitiv të marrë paraprakisht nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Institucioni publik shëndetësor pas vërtetimit se në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mund të sigurohet lloji i këtillë i pajisjes, ka vërtetuar se duhet të bëjë import të pajisjes së lartpërmendur nga një vend tjetër.

Duke i pasur parasysh dispozitat nga Ligji për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, me të cilat është vërtetuar kthimi i tatimit të paguar të vlerës së shtuar, i cili është paguar për qarkullim të të mirave materiale por jo edhe për import, ka kërkuar nga kompania V në Republikën e Maqedonisë së Veriut të kryejë import të pajisjes që më vonë e njëjta t'i shitet institucionit publike shëndetësor.

Megjithatë kompania V, vlerës së pajisjes së importuar i ka shtuar edhe marzhë të caktuar profitabile prej 5% me çka e ka rritur vlerën e pajisjes, me çka sasia për vlerën e pajisjes në fakturë e ka tejkaluar vlerën e donacionit në para të përmbajur në vendimin e Ministrisë së Drejtësisë. Kompania që e ka dhënë donacionin është pajtuar t'i dhurojë edhe mjetet shtesë për blerje të pajisjes.



### SI ËSHTË VEPRUAR



Institucioni publik shëndetësor ka kërkuar ndryshim të vendimit të Ministrisë së Drejtësisë drejt së cilës e ka eksponuar aneksin kontratës për donacion me të cilën kryhet korrigjim i vlerës së mjeteve të dhuruara. Në bazë të aneksit Ministria e Drejtësisë ka kryer ndryshim të vendimit fillestar me vlerë të korrigjuar.

Institucioni publik shëndetësor B, fakturën e pranuar së bashku me dëshmitë për pagesë të tatimit të vlerës së shtuar në llogarinë speciale të Buxhetit të RMV nga ana e kompanisë së lartpërmendur me kërkesë në formular të caktuar në dy ekzemplarë dhe kopje nga vendimi i Ministrisë së Drejtësisë i ka deponuar në Ministrinë e Financave.

Ministria e Financave ka kryer kthim të tatimit të paguar të vlerës së shtuar kompanisë V, e cila e ka kryer importin e pajisjes, ndërsa më tej edhe qarkullimin kundrejt institucionit shëndetësor.

## SI ËSHTË DASHUR TË VEPROHET KONFORM PRAKTIKËS SË MIRË

Duhet të mundësohet që institucioni publik shëndetësor të dërgojë vetëm njoftim në Ministrinë e Drejtësisë, sepse nga ana e këtij organi vlerësohet interesi publik, e jo vlera e mjeteve me të cilat realizohet interesi publik.

**Sfidë:** Tejkallim i barrierave administrative gjatë zbatimit të donacionit me interes publik, gjegjësisht thjeshtim i procedurës e cila ka vetëm ndryshim të vlerës.

## VENDIM

### ► ndryshim i procedurës

Ligji duhet të mundësojë procedurë të thjeshtuar, gjegjësisht në rast të ndryshimit të vlerës së shtuar në vend që të dorëzohet aneksi i kontratës me të cilën ndërrohet vlera dhe të pritët vendim i ri me vlerën e ndryshuar, të parashikohet vetëm njoftim nga ana e pranuesit të donacionit për ndryshim të vlerës.



## KYÇU! PLANIFIKO! DHURO!

Ky publikim është përgatitur nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Qendrës për politikë tatimore. Shoqata Konekt dhe autorët e përmbajtjeve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqesin qëndrimet e Bashkimit Evropian.



## PËR KONEKT

**Konekt** me përkushtim punon në nxitjen e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore dhe është hallka kyçe për ndërlidhje të donatorëve me sektorin civil për krijim të ndikimit pozitiv në shoqëri.

**Projekti "Ndryshime për qëndrueshmëri"** është financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatuar nga Konekt në partneritet me Fondacionin Apollonia dhe Qendrën për politikë tatimore. Projekti ka kontribuar që organizatat civile (OC) të përballen me sfidën e qëndrueshmërisë financiare përmes:

- bashkimi i 100 OC në Rrjetin për qëndrueshmëri financiare që përfaqëson për politika dhe ligje më të mira që do të mundësojnë organizata më stabile dhe më të fuqishme civile.
- një sërë trajnimesh, mbështetje mentore dhe mjete të dedikuara për organizatat më të vogla lokale.
- 16 grate për OC mbështetje të nismave për grumbullim të mjeteve dhe partneriteteve ndërsektoriale, në të cilat organizatat civile, institucionet lokale dhe bizneset punojnë së bashku që të krijojnë ndryshime pozitive në komunitet.